



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 7 datë 08/02/1996

**PER
ORGANIZIMIN E NJE VIZITE PUNE NE KESHILLIN BASHKIAK TE
VIENES (AUSTRI).**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e dt.08.02.1996, me propozim të këshilltarëve nga komisione të ndryshme, në kuadrin e zgjerimit të kontakteve të filluara, të marrjes së përvojës nga jashtë edhe në nivel pushteti lokal,

V E N D O S I

1. Të kryejë një vizitë pune për marrje përvojë në Këshillin Bashkiak të Kryeqytetit të Austrisë, Vjenë.
2. Në rakordim me palën austriake kjo vizitë të kryhet brenda 6 mujorit të parë të këtij viti.
3. Në këtë vizitë do të marrin pjesë këshilltarët e të gjitha komisioneve si dhe 4 punonjës të aparatit që lidhen më tepër me veprimtarinë e tyre.
4. Për realizimin e kësaj vizite të parashikohen në Buxhetin e Bashkisë për vitin 1996, ose në fondin rezervë të saj 28 mijë dollarë USD.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen komisionet përkatëse të Këshillit Bashkiak, Drejtoria e Administrimit Financiar dhe Seksioni i Marrëdhënieve me Jashtë i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA